

Nr. 01-10351/1  
Shkup 15.10.2021

Në bazë të nenit 27 të Statutit të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore, dhe në përputhje me Vendimin për mënyrën e përdorimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve zyrtare të miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.214/21), Drejtori i Ndërmarrjes Publike për Rrugët Shtetërore, miratoi

## **UDHËZIME**

### **për mënyrën e përdorimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve zyrtare të ndërmarrjes publike për rrugët shtetërore**

#### **Dispozitat e përgjithshme**

##### **Neni 1**

Me këtë udhëzim përcaktohen kushtet dhe mënyra e përdorimit të automjeteve zyrtare në ndërmarrjen publike për rrugët shtetërore, ruajtjen dhe monitorimin e përshtatshmërisë teknike të automjeteve zyrtare, regjistrimin e automjeteve zyrtare, dëmtimin ose vjedhjen e automjetit zyrtar dhe përcakton dokumentacionin e nevojshëm të përdorur për kryerjen e veprimtarisë.

##### **Neni 2**

Dispozitat e këtij udhëzuesit kanë të bëjnë për të gjithë personat që drejtojnë automjete zyrtare.

Automjet zyrtar në kuptim të këtij udhëzimi është çdo mjet që është në pronësi të ndërmarrjes publike për rrugë shtetërore.

Një automjet zyrtar mund të përdoret nga një i punësuar ose një person i caktuar për punë të përkohshme në ndërmarrjen publike për rrugë shtetërore, i cili posedon një patentë shoferi të vlefshëm.

##### **Neni 3**

Përdorimi i automjeteve duhet të jetë i miratuar, i justifikuar, i qëllimshëm dhe racional dhe në përputhje me objektivat dhe fushën e punës së ndërmarrjes publike (nevojat zyrtare). Automjetet zyrtare përdoren me vëmendje një ekonomistit të mirë.

Kushtet dhe mënyra e përdorimit të automjeteve zyrtare

#### Neni 4

Automjetet zyrtare përdoren ekskluzivisht për ushtrimin e kompetencave të ndërmarrjes publike për rrugë shtetërore. Automjetet zyrtare nuk duhet të përdoren për shkuarjen dhe ardhje nga puna ose për qëllime të tjera private.

#### Neni 5

Për të përdorur automjetin zyrtar, përdoruesi duhet të ketë një urdhër udhëtimi mujor (Shtojca nr. 1).

#### Neni 6

Me plotësimin e nevojës për përdorimin e mjetit zyrtar, përdoruesi mbyll urdhërin duke plotësuar të dhënat për kohën e kthimit, gjendjen e kilometrazhit dhe numrin e kilometrave të përshkuara dhe ia dorëzon personit përgjegjës për parkun vozitës së bashku me çelësin e automjetit.

#### Neni 7

Automjet zyrtar për udhëtime zyrtare përdoret nëse përdoruesi ka një urdhër rrugor të miratuar për udhëtime zyrtare (duke deklaruar nevojën, datën, kohën e nisjes. (Shtojca nr.2)

#### Neni 8

Përdoruesi gjatë kthimit të automjetit raporton defekte të mundshme mekanike dhe të tjera nëse ato kanë ndodhur gjatë përdorimit të tij tek personi përgjegjës për parkun vozitës.

#### Neni 9

Nëse përdoruesi kthehet nga një udhëtim zyrtar pas përfundimit të orarit të punës, për këtë do të informon udhëheqësin e tij të drejtpërdrejt dhe personi përgjegjës për parkun vozitës.

#### Neni 10

Përdorimi i automjetit zyrtar pas përfundimit të orarit të punës miratohet nga drejtori.

#### Neni 11

Mbushja e benzinës në automjetin zyrtar kryhet nga përdoruesi që përdor automjetin, pas nevojës së deklaruar më parë për të, për të cilën fatura fiskale, së bashku me faturën e llogarisë, i dorëzohet personit përgjegjës për parkun vozitës.

### **Ruajtja dhe monitorimi i rregullshmërisë teknike të automjeteve zyrtare**

#### Neni 12

Përdoruesi i një automjeti zyrtar e parkon automjetin në një hapësirë parkimi të destinuar për automjetet e ndërmarrjes publike pas plotësimit të nevojës zyrtare.

#### Neni 13

Përgjegjësi i parkut vozitës është përgjegjës për monitorimin e gjendjes teknike të automjetit.

Çdo muaj, personi përgjegjës për parkun vozitës kryen një inspektim vizual të automjeteve duke përdorur një listë të inspektimit të automjeteve (Shtojca nr. 3).

#### Neni 14

Nëse konstatohet ndonjë problem në automjet, personi përgjegjës për parkun vozitës i drejtohet shërbimit të autorizuar ose furnizuesit të jashtëm me të cilin ndërmarrja publike për rrugë shtetërore ka lidhur një kontratë për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve.

#### Neni 15

Personi përgjegjës për parkun vozitës është i detyruar jo më vonë se 10 ditë para dhe 10 ditë pas skadimit të periudhës për mbajtjen e pajisjeve dimërore (15.11-15.03), të organizojë ndryshimin e pajisjeve të automjeteve nga mënyra verore në atë dimërore dhe anasjelltas.

#### Neni 16

Çdo automjet duhet të mirëmbahet në mënyrë higjienike. Çdo automjet duhet të pastrohet, të paktën një herë në muaj ose më shpesh në varësi të gjendjes së tij për të cilën personi përgjegjës për parkun vozitës është përgjegjës.

### **Riregjistrimi i automjeteve zyrtare**

#### Neni 17

Personi përgjegjës për parkun vozitës mban një listë për shërbime të rregullta (Shtojca nr. 4) në të cilën kryen regjistrime të serviset periodike të realizuara dhe serviset të planifikuara pasuese. Për çdo servis të rregullt, të dhënat futen në Kartën e servisit (Shtojca nr. 5).

#### Neni 18

Në rast nevoje për servise të jashtëzakonshme për automjetet - defekt, dëmtim, etj., personi përgjegjës për parkun vozitës i çon automjetet në erviss (të përzgjedhur me furnizim publik), dhe pas riparimit, regjistron të dhënat nga servisi i jashtëzakonshëm në Librezën amë të automjetit (Shtojca nr.6). Personi përgjegjës për parkun vozitës është

i detyruar të bashkëngjisin një kopje të faturës për pjesët e ndryshuara të atij automjeti në kartën amë për atë automjet.

Nëse servisi nuk është në përputhje me kërkesën e servisit, reklamohet me anë të ankesës.

#### Neni 19

Personi përgjegjës për parkun vozitës planifikon regjistrimin e automjeteve në Planin e Regjistrimit të Automjeteve (Shtojca nr. 7) dhe organizon regjistrimet në përputhje me planin. Automjete për regjistrim i dërgon me autorizim të lëshuar nga ana e drejtorit.

### **Dëmtimi ose vjedhja e automjetit zyrtar**

#### Neni 20

Nëse, gjatë përdorimit të një automjeti zyrtar, ndodh dëmtimi i tij, përdoruesi i automjetit njofton personin përgjegjës për mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare dhe ka detyrimin t'i afrohet përgatitjes së procesverbalit evropian ose të kërkojë ndihmë nga një autoritet kompetent për përgatitjen e procesverbalit.

Nëse gjatë përdorimit të automjetit zyrtar ndodh vjedhja, përdoruesi njofton menjëherë personin përgjegjës për mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare dhe në të njëjtën kohë raporton vjedhjen në stacionin policor më të afërt.

### **Dispozita përfundimtare**

#### Neni 21

Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij dhe do të publikohet në ueb faqen e Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore.

Drejtor

Ejup Rustemi